

* Drejtor Arkivi Shtetëror i Kosovës, Prishtinë

OSMANI, Jusuf, *Private Archival Material in Kosovo*. Atlanti, Vol. 18, Trieste 2008, pp. 359-366.

Original in Albanian, abstract in English, Italian and Slovenian, summary in English

Key words: *private archival material, private archives, submission of archival material, private and legal persons, private institutions, private organizations.*

This subject aims at presenting the importance of the archival material collected by private and legal persons in Kosovo. Private archival material is of special importance to history, culture, science, economy, etc. Up until now, Kosovo did not demonstrate a need for such archival material. Now that it has entered a phase of transition and social and state property is being privatized by the Kosovo Trust Agency established by UNMIK and Kosovo institutions, various owners are archiving materials on this line and will do so in the future. This archive, therefore, is increasingly gaining importance and drawing interest. This abstract presents scant legal dispositions, which regulate this archive, rights of accessibility and usability, rights of providers, importance of this material, educative personnel, etc.

OSMANI, Jusuf, *Archivi privati in Kosovo*. Atlanti, Vol. 18, Trieste 2008, pp. 359-366.

L'articolo ha lo scopo di evidenziare l'importanza del materiale archivistico in possesso di privati ed istituzioni del Kosovo. Il materiale privato è di importanza particolare per la storia, la cultura, la scienza, l'economia, ecc. Fino ad ora, il Kosovo non ha dimostrato particolare attenzione a questo materiale. Ora che è entrato in una fase di transizione, e la proprietà sociale e dello stato è stata privatizzata dall'Agenzia kosovara di gestione fondata dalla Missione ONU in Kosovo, molti possessori di archivi stanno archiviando il proprio materiale su tale linea e così continue-

Rëndësia e lëndës arkivore private

Lënda arkivore private, sikurse ajo publike është memorie e një shteti, përkatësisht e një populli. Është e qartë se çdo njeri memorien e vetë duhet ta ruaj dhe të kujdeset për të. Memorien e përbëjnë njëjtë si lënda publike edhe ajo private. Lëndë arkivore private, llogaritet dokumentacioni i krijuar me veprimtarinë e personave privato-juridik dhe fizik, nëse nuk është krijuar gjatë kryerjes të autorizimeve ose kryerjes së shërbimeve publike dhe nëse nuk është në pronësinë shtetërore.

Sipas dispozitave ligjore, lënda arkivore është definuar sipas rëndësisë së saj si lëndë arkivore publike, dhe si lëndë arkivore private. Lënda e institucioneve private dhe e individëve e ka statusin e lëndës arkivore. Dallimi në definicion është përcaktuar sipas mënyrës së krijimit të asaj lënde nëpërmjet shërbimeve publike, të cilat i kryejn ose nuk i kryejn krijuesit e lëndës.

Për dallim nga lënda arkivore publike, lënda arkivore private krijohet me veprimtarinë e personave juridik dhe fizik, përkatësisht krijohet nëpërmjet të formave të veprimtarisë, ku nuk janë kryer punët publike ose autorizimet publike.

Duhet theksuar se në të kaluarën ekzistonte një sasi e vogël e lëndës arkivore në pronësinë private. Ai ishte dokumentacion lidhur me jetën dhe punën e personaliteteve të njohura publike ose familjeve, dhe e një numri të vogël të subjekteve private. Poseduesit e atij dokumentacioni, kryesisht atë e kanë dorëzuar në arkiv nëpërmjet të faljes ose shitjes.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e lëndës arkivore private, në Konferencën e Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave, të mbajtur më 14 nëntor 2006 në Kurosao të Antileve holandeze, në mes të pikave të aprovuara u aprovua edhe rezoluta për arkivat private, ku thuhet: “*Duke theksuar se arkivat publike dhe private janë elemente themelore të memories së shoqërisë në tërësi, si dhe si të tillë duhet të ruhen: Duke konsideruar se arkivistët kanë rolin qenësor në zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë, e cila në mënyrë aktive ndihmon krijimin, pranimin dhe ruajtjen e lëndës së organeve private, me qëllim që të ndërrohet baraspesha dhe memoria gjithëpërfshirëse e shoqërisë. Lutet KNA*

që të përparojë ndërgjegjien e përgjithshme për rëndësinë dhe vlerën e të gjitha këtyre arkivave; që të shqyrtojë realizimin e themelimit të seksioneve të arkivave private”.

Natyrisht, çdo arkiv privat tek individët dhe familjet nuk kanë rëndësi të njëjtë. Disa prej tyre janë në një shkallë më të lartë të vlerës, e disa kuptohet më të ulët. Kjo është për arsye të strukturës dhe përbërjes së arkivave private, të cilat varen nga koha dhe vendi kur familjet ose personat e caktuar, kanë vepruar nga profesioni i tyre, pozitat me të cilat ata janë marrë, për preokupimet personale të individëve, shkalla e ruajtjes së lëndës arkivore të veprimtarive të tyre nga ajo periudhë, etj. Por, çfardo rasti këto dokumente mund të paraqesin burit të vazhdueshëm dhe të rëndësishëm të informatave.

Ndërsa, në anën tjetër edhe rëndësia e lëndës arkivore të organizatave private, po ashtu nuk është e një rëndësie të njëjtë. Aja varet nga veprimtaria e saj, shtrirja territoriale, roli i saj në zhvillimin e shtetit dhe të tjera.

Periudha e tranzicionit

Çdo sistem politik e ka fillimin e tij, periudhën e zhvillimit dhe të ekspansionit, dhe pastaj fundin e vet. Këtë e përjetoj edhe Jugosllavia, në përbërjen e së cilës deri në vitin 1999 ishte edhe Kosova. Pas mbarimit të luftës, largimit të forcave serbe, Kosova hyri nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, përkatësisht të UNMIK-ut. Gjatë luftës një pjesë e madhe e dokumentacionit arkivor ishte shkatërrua, ndërsa një pjesë që bënte kryesisht me çështjet pronëso-ro-juridike dhe atyre të gjendjes civile, është bartur nga Kosova dhe edhe sot gjendet në qytete të ndryshme të Serbisë.

Që nga ajo kohë e deri më 17 shkurt 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë, si shtet sovran, ajo kaloi në një fazë të re të tranzicionit. Në këtë kohë në Kosovë, përveç UNMIK-ut, vepronin edhe organet vendore të zgjedhura nga populli, forcat e KFOR-t, OSCE dhe shumë organizata humanitare dhe joqeveritare. Puna dhe veprimtaria e tyre u reflektua edhe në krijimin, llojin, sasinë, përmbajtjen etj. të lëndës arkivore.

Në këtë periudhë në Kosovë ende nuk kishte një sistem të caktuar të menaxhimit zyrtar dhe arkivor. Zbatoheshin sistemet nga periudhat e mëhershme. Ndërsa, në disa kuvende komunale, ku administrator ishin caktuar nga vendet e ndryshme të botës, ata në shumë raste aplikonin sistemin e menaxhimit zyrtar të vendit të tyre. E tërë kjo u reflektua edhe në krijimin, evidencimin, klasifikimin, arkivin, ruajtjen etj. të lëndës arkivore.

Mirëpo, me angazhimin e arkivave të Kosovës në mbështetje të Qeverisë së Kosovës, gjendja ka filluar të ndryshohet në të mirë. Në këtë aspekt, Arkivi i Kosovës që në fillim është angazhuar në ndihmë institucioneve të reja dhe atyre ekzistuese në aspektin e udhëheqjes së afarizmit zyrtar, në mbrojtjen dhe klasifikimin e lëndës arkivore. Pëkitazi me këtë së bashku me organet publike ka sjell Ligjin për lëndën arkivore dhe arkivat si dhe disa udhëzime për menaxhim zyrtar, mbrojtjen, klasifikimin, seleksionimin, pranim-dorëzimin e lëndës arkivore dhe të tjera. Në kohë të fundit është duke punuar edhe

ranno a fare in futuro. Questo archivio, peraltro, sta assumendo sempre più importanza ed attirando sempre più interesse. Questo abstract presenta alcune disposizioni legali che regolano questo archivio, come il diritto all'accesso ed all'utilizzo, i diritti di chi fornisce il materiale, l'importanza del materiale, la formazione del personale, ecc.

OSMANI, Jusuf, Zasebno arhivsko gradivo na Kosovem. Atlanti, Zv. 18, Trst 2008, str. 359-366.

V prispevku avtor razpravlja o pomembnosti arhivskega gradiva, ki je bilo zbrano po zasebni poti na Kosovem. To gradivo ima nedvomno velik pomen za zgodovino, kulturo, znanost, ekonomijo, itd. Zdi se, da na Kosovem do sedaj niso dovolj poskrbeli za arhivsko dejavnost, ampak šele v zadnjem času, ko so stopili na pot tranzicije in sociale oz. po privatizaciji, saj se je z privatizacijo pokazalo, da so dokumenti zelo pomembni. V prispevku avtor predstavlja zakonodajo, ki bo uravnavala arhivsko dejavnost, dostopnost do dokumentacije, pravice uporabnikov, pomembnost varovanja in brambe dokumentov, izobraževanje, itd.

SUMMARY

Kosovo is now in transitional phase, when public property is becoming private. After the end of the war, in 1999, Kosovo was placed under the administration of United Nations, known as UNMIK (United Nations Mission in Kosovo). International administration and local authorities in Kosovo, established from the outset of post-war, the Kosovo Trust Agency. This Agency, directed by the international administration has supervised the privatization process of public and state property. This year, the agency turned into Kosovo Agency for Privatization and under local chairmanship. These changes have been reflected throughout the system, type, quantity and content of archival material. When it comes to archives, nothing has been undertaken as of now. Documentation of entities privatized by the Agency remains assembled in one place and has not yet undergone classification, selection, registration, etc. in order to be submitted to official archiving authorities. Kosovo Archives Directorate obliged by the Law on Archival Material and Archives (Law nr. 2003/17), has required protection and classification of that documentation and, in this regard, has provided professional guidance, but nothing has moved towards realizing this aim. On the other hand, no legal dispositions are available to solve issues of obligations and relations between the newly privatized enterprises and the States Archives. This issue requires urgent address and on a wider level of world archives services, since such problems are to be found on regional level also. Now that private activity has sprouted, archives gain a new role and additional tasks require it to provide permanent

and adequate supervision. In this context, meeting international standards becomes an additional task. Kosovo Archives Directorate, in addition to archival material in private organizations, and companies with shared ownership between state and private holders, provides special care to the protection, documentation and archiving material submitted by various individuals, non-governmental and religious organizations who have produced and will produce archival material.

në sistemin e menaxhimit, arkivimit dhe të ruajtjes së dokumenteve elektronike.

Duhet theksuar, se të gjitha ndryshimet e sistemit shoqëroro-politik duhet t'i respektojë edhe shërbimin arkivor, duke përfshirë edhe lëndën arkivore të paratrazicionit, të tranzicionit dhe atë pastranzicionit, posaçërisht lëndën arkivore private.

Transformimi i punës shoqërore në pronë private në Kosovë

Në periudhën e pasluftës filloi edhe transformimi i pronës shoqërore në pronë private. Nga ana e bashkësisë ndërkombëtare u formua Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, që udhëheqej nga ndërkombëtarët dhe vendorët. Detyrë e kësaj ishte privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, me kalimin e kompetencave në duar të vendorëve, përkatësisht të Qeverisë së Kosovës, ky Agjencion kaloi nën menaxhimin e vendorëve dhe filloi të quhet Agjencioni Kosovar i Pronave.

Problem të veçantë paraqet me dokumentacioni i ndërmarrjeve të privatizuara. Agjencioni kompetent për privatizim, me punën e deriatëhershme të atyre organizatave nuk i kushtonte rëndësi dokumenteve të krijuara. Ai atë dokumentacion e grumbulloi në një vend të caktuar, që në ndërkohë të bëjë klasifikimin, seleksionimin, regjistrimin dhe përgatitjen për dorëzim arkivit kompetent. Mirëpo, dokumentacioni në fjalë ende nuk është klasifikuar dhe nuk i është dorëzuar arkiviave. Tani ka filluar që kjo çështje të lëvizë në të mirë. Të krijohet në qendër e dokumentacionit, ku tërë lënda arkivore e organizatave të privatizuara të klasifikohet, sistemohet, seleksionohet, të regjistrohet dhe të përgatitet për dorëzim arkivit.

Krijuesit e lëndës arkivore private

Në kohën e sotme kur po ndryshojnë marrëdhëniet pronësore në vend, po ndryshohet edhe struktura pronësore në kontekst me lëndën arkivore. Sot po paraqiten situata, që gjithnjë e më pak po ekziston pronësia shtetërore. Gjithnjë e më shumë po bëhet privatizimi, kështu që kemi forma të ndryshme të pronësisë – ajo private, gjysmë private, deri te situata që personat e ndryshëm të jashtëm juridik dhe fizik të janë pronarë të lëndës arkivore.

Nëpërmjet privatizimit po shtohet edhe numri i krijuesve të lëndës arkivore. Sot, si krijues dhe posedues, por edhe si pronarë të lëndës po bëhen ndërmarrjet aksionare, kompanitë e ndryshme, partitë politike, shoqatat, organizatat joqeveritare, personat privatë, sindikatat, institucionet fetare, përfaqësitë e jashtme etj. E tërë kjo është më karakteristike në Kosovë, si vend që kaloi nga sistemi komunist njëpartiak në atë shumë partika dhe që një kohë të gjatë ishte në periudhën e tranzicionit. Me veprimtarinë e tyre janë krijuar dhe po krijohen dokumente të shumta me interes të veçantë për arkivat tona.

Roli dhe obligimet e arkivit

Për shkak të shtimit të numrit të atyre kategorive të reja të krijuesve privatë të lëndës arkivore, para shërbimit arkivor paraqitet një problem dhe qasje e re në dokumentet e reja të krijuara, jo vetëm ato konvencionale, por edhe jokonvencionale. Po shprehet brengosja për atë se ende nuk ka siguri se a do të ruhen, si do të ruhen, çka do të ruhet, ku do të ruhen dokumentet të këta krijues të rinj. Arkivi, tani po merrë një rol të ri. Përkitazi me këtë para arkivave shtrohen detyra të reja, të rëndësishme dhe të ndërlikuara.

Tani, imponohet nevoja që arkivat duhet të kooperojnë me organizatat dhe krijuesit të tjerë privatë se si të menaxhojnë dhe si ta ruajnë dokumentacionin. Edhe shteti duhet të angazhohet në këtë drejtim. Nëpërmjet të ligjslacionit, por edhe me mjete financiare të krijojë kushtet dhe detyrimet e ruajtjes së këtij dokumentacioni, që ka vlerën e trashëgimisë kulturore, që pas një periudhe të caktuar kohore ai dokumentacion të kalojë në arkivat e shtetit.

Evidencimin e lëndës arkivore në pronësinë private e bëjnë arkivat. Arkivat përcaktojnë regjistrin e poseduesve të lëndës arkivore në pronësinë private, për të cilët sipas vlerësimit të tyre profesional, konstatojnë se është me interes për shtetin dhe popullin. Regjistrin e mban shërbimi përkatës i arkivit me shënimet e duhura.

Shërbimi kompetent arkivor, lëndën arkivore në pronësinë private, duhet ta evidencojë dhe në mënyrë të përhershme ta mbikëqyrë. Te poseduesit - individët ata kohë pasë kohe t'i vizitojë dhe me këshilla profesionale t'i ndihmojë që atë sa më mirë ta ruajnë. Ndërsa, organizatave private t'u ndihmojë në krijimin e sistemeve profesionale dhe menaxhimin më dokumentet arkivore dhe njëkohësisht ruajtjen e tyre.

Obligimet e krijuesve të lëndës arkivore private

Në bazë të dispozitave ligjore vendore dhe ndërkombëtare parashtrihen detyra të shumta të krijuesve të lëndës arkivore private. Në Kosovë përkitazi me këtë aplikohen disa dispozita të Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat (Ligji nr. 2003/7).

Poseduesit e lëndës arkivore private, pa marrë parasysh se në çfarë baze e ruajnë lëndën arkivore ose dokumente të veçanta me vlerë të përhershme, janë të obliguar që:

- ta informojnë arkivin kompetent për posedim me dokumente;
- ta ruajnë lëndën arkivore dhe të ndërmarrin masa të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e saj në gjendje të rregullt dhe të sigurt;
- ta rregullojnë lëndën arkivore dhe të bëjnë regjistrimin e saj;
- t'i mundësojnë personit të autorizuar të arkivit kompetent që të shikojë lëndën arkivore dhe sipas nevojës të bëjë incizimin e saj për nevoja sigurie;
- të veprojnë sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të arkivit, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së lëndës arkivore.

Nëse poseduesi (fjala është për individin) i lëndës arkivore private, nuk është në gjendje dhe nuk ka mundësi që lëndën arkivore ta regjistrojë dhe ta rregullojë, është i obliguar që t'ia mundësojë arkivit kompetent që ta bëjë atë me shpenzime të veta.

Përveç kësaj, poseduesit e lëndës arkivore private duhet të obligohen që arkivave publike t'ua dërgojnë shënimet për lëndën arkivore në pronësinë e tyre, si dhe t'ua mundësojnë shfrytëzimin e saj.

Lënda arkivore te individët dhe familjet

Sikurse edhe në viset tjera të botës, edhe në Kosovë krijues të lëndës arkivore në të kaluarën, por edhe sot, janë individët dhe familjet, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në jetën politike, arsimore, kulturore, shkencore etj. Ata kanë krijuar dhe poseduar dokumente të shumta me interes për të kaluarën historike.

Në Kosovë, për shkak të gjendjes politike, në të kaluarën lënda arkivore e krijuesve privatë në masë të vogël është dorëzuar në arkiv. Shumë prej tyre nuk kanë qenë të informuar për mundësinë e dorëzimit në arkiv. Disa poseduesve dokumentacioni u është shkatërruar gjatë luftës së fundit. Pas vdekjes së poseduesit disa familje kanë shprehur interesim dhe kanë filluar të dorëzojnë lëndën në arkiv. Mirëpo, ka raste që dokumentacioni i disa poseduesve të tillë, për shkak të mosinteresimit të trashëgimtarëve dhe mosinformimit të arkivit, dokumentacioni i tyre është shkatërruar ose tjetërsuar. Me informimin e arkivit për posedues të tillë të lëndës arkivore, shërbimi përkatës i arkivit vendos kontakte me pronarët, përkatësisht trashëgimtarët dhe atë dokumentacion ka filluar ta sjellë në arkiv, kryesisht nëpërmjet të faljes ose dhënies në depozit.

Lënda arkivore te institucionet fetare

Posedues të lëndës arkivore private në mes tjerash janë edhe institucionet fetare. Ato kanë poseduar një sasi të madhe të lëndës arkivore, sidomos ato të konfesionit islam. Mirëpo, në luftën e fundit të agresorit pushtetar serb janë djegur dhe shkatërruar arkivat, bibliotekat dhe dorëshkrimet e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të bashkësive të komunave dhe janë djegur 82 xhami. Kjo ishte një humbje shumë e madhe e trashëgimisë kulturore të kësaj treve. Tani këto institucione posedojnë shumë pak dokumente dhe dorëshkrime. Në masë të vogël e njëjta gjë ka ndodhur edhe me dokumentacionin e ndonjë kishe katolike në Kosovë, siç ishte ajo e Gjakovës. Përkitazi me dokumentacionin e institucioneve fetare ortodokse në Kosovë nuk kemi njohuri, meqenëse nuk kemi pasur qasje. Ndoshta, ai dokumentacion është bartur nga Kosova ose një pjesë e vogël e tij edhe mund të jetë shkatërruar në vitet e pasluftës, gjatë disa disa çrregullimeve në Kosovë.

Dorëzimi dhe shfrytëzimi i lëndës arkivore private

Të bazuar në faktin se lënda arkivore e personave privatë-juridikë, ajo e individëve bën pjesë në kategorinë e pronarëve privatë, arkivat kryesisht janë të përkufizuar në marrjen e atij lloji të dokume-

nacionit. Ata varen, kryesisht nga gatishmëria e individëve në pjesëmarrjen dhe në vetëdijësimin e tyre për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Sipas normave dhe dispozitave ligjore vendore dhe ndëkombëtare, poseduesit e lëndës arkivore, individët dhe familjet mund t'ia dorëzojnë lëndën arkivore arkivit në këto forma juridike: me anë të kontratës në formë depoziti, duke e ruajtur të drejtën pronësore, në formë të faljes ose të blerjes. Në Kosovë dorëzim-pranimi i lëndës arkivore në pronësinë private është i rregulluar me nenin 10 të Ligjit mbi lëndën arkivore dhe arkivat dhe nenit 16-21 të Udhëzimit administrativ për dorëzim-pranimin e lëndës arkivore.

Dorëzim-pranimi i lëndës arkivore private në arkiv, bëhet nëpërmjet të dokumenteve të shkruara, kryesisht nëpërmjet dokumenteve të shkruar, kryesisht nëpërmjet të kontratës. Në kontratë ose dokument tjetër theksohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Lënda arkivore, e cila është sjell në arkiv nëpërmjet faljes ose blerjes, shfrytëzimi i saj bëhet nën kushtet dhe në mënyrën, e cila vlen për lëndën arkivore publike, vetëm nëse nuk është theksuar ndryshe në kontratë ose në dokument tjetër për dorëzim arkivit.

Detyrat në të ardhmen

Shtrohet pyetja se si të veprojmë në të ardhmen në mbrojtjen dhe grumbullimin e lëndës arkivore të poseduesit privatë, posaçërisht të individët dhe familjet. Në radhë të parë duhet të bëhet vetëdijësimi i popullatës. Ekziston qëndrimi i përbashkët i të gjithë arkivistëve të botës, që me një propagandë të vazhdueshme në çdo shtet të theksohet rëndësia e grumbullimit të lëndës arkivore në pronësinë private dhe dorëzimi i tyre në arkivat qendrore. Me këtë duhet të besojnë se arkivat posedojnë kushte më të mira dhe më të sigurta të vendosjes dhe të ruajtjes sesa gjendja e tyre në pronësinë private. Në këtë mënyrë ajo lëndë, do të deponohej në një vend dhe në të, do të kenë qasje të gjitha ata, të cilët merren me studimin e të kalures. Në aspektin financiar do të bëhej edhe një kursim si të ruajtësi ashtu edhe të shfrytëzuesi i lëndës arkivore. Në rastin e parë do të ruhej në një vend në kushte optimale, ndërsa në rastin e dytë për hulumtues, lënda do të jetë në një vend dhe do të kursente në kohë.

Në disa vende të botës, para disa kohe kanë filluar të formohen arkivat ekonomike si institucione të veçanta e të pavarura, të cilat pranojnë dhe ruajnë lëndën arkivore, e cila krijohet në organizatat private, tregtare, të bankave e të tjera. Ato financohen kryesisht nga themeluesit e tyre.

Edhe në Kosovë, mendoj se duhet vepruar në këtë mënyrë. Me mjete të përbashkëta, disa krijues privatë, posaçërisht sipas lëmenjve të caktuar të krijojnë arkiva, përkatësisht qendra të dokumentacionit. Në to, tërë lënda arkivore do të klasifikohet, seleksionohet, evidencohet, të ruahet dhe të shfrytëzohej.

Në aspektin legjislativ në mënyrë decitive duhet të rregullohen marrëdhëniet ndërmjet arkivave dhe të krijuesve të lëndës arkivore private, krijuesve të lëndës arkivore që pjesërisht janë private dhe

pjesërisht shtetërore, të kompanive të huaja që kanë investuar kapitalin në Kosovë dhe njëherit edhe krijojnë dokumentacion arkivor dhe shumë çështje të tjera lidhur me dokumentacionin arkivor të proviencës private.

Arkiva, por edhe krijuesit e rinj, posaçërisht kompanitë private duhet të angazhohen edhe në përgatitjen e kuadrit profesional për punë me dokumentacion arkivor që nga momenti i krijimit e deri të ruajtja dhe shfrytëzimi i tij. Deri më tani nga ato organizata private, pothuajse, asgjë nuk është ndërmarrë në këtë aspekt.

Përfundim

Si përfundim do da merrja një vlerësim nga referati I Jean Wilfrid Bertrand, me titull: *Privatizimi i ndërmarrjeve të sektorit privat, strategji e arkivave të vendeve në zhvillim*, të paraqitur në Konferencën e 35-të Ndërkombëtare të Tryezës së Rrumbullakët të Arkivave të mbajtur në Reikjavik të Islandës, ku ndër të tjerash thuhet: “*Një mision, një vision për shekullin XXI arkivistët e vendeve më pak të zhvilluara përballë ndryshimeve të mëdha social-ekonomike dhe teknologjike të shekullit, apelon: Një mision, për ruajtjen e kujtesës kolektive, një vizion për t’i shërbyer kësaj kujtese, për të përmirësuar të tashmen dhe të ardhmen, që duken utopike aqsa kundërshtitë dhe vështirësitë për të kapërcyer janë të shumta. Të kapur në vorbullën e ndryshimeve të mëdha teknologjike dhe të globalizimit të ekonomisë që i shoqëron ato, jemi si të hutuar përballë gjerësisë së punëve që duhet të përmbushim. Ne duhet të tregohemi mendjehollë dhe krijues duke shpërndarë “recetat” tona gjatë takimeve tona....*

Do të na duhet, që së pari të bindim qeveritë tona për punët e mëdha për një miradministrim të arkivave tona dhe më vonë partnerët tanë të sektorit privat për t’u bërë atyre të ditur që ne punojmë gjithashtu për ta. Duhet të jemi të palodhur, të duruar, të aftë për të ndjekur burimet financiare, gjithashtu edhe shumë të shqetësuar për të racionalizuar shpenzimet tona në vendet, ku qeveritë tona kanë një prirje, tendence të madhe për të jetuar mbi nivelin mesatar. Ne duhet të jemi gjithashtu shumë vigjilentë dhe të kujdesshëm në marrjen e vendimeve që mund të prekin, nga afër ose nga larg, atë që përbën edhe thelbësoren e profesionit tonë.

LITERATURA

Ligji për lëndën arkivore dhe arkivat (Ligji nr. 2003/7, 17 prill 2003).

Udhzimi administrativ për pranimitë-dorëzimin e lëndës arkivore, qershor 2007.

Živana Hadjbeli, *Privatno arhivsko gradivo*, «Arhivski Vjesnik», br. 44, Zagreb, 2001.

Arhivski standardi i postupci Državnog arhiva Quebeca, Zagreb, 1994.

Azem Kožar, *Arhivistika u teoriji i praksi 2*, Tuzla, 2005.

Mustafa Dervišević, *Privatni arhiv*, «Arhivska praksa», Tuzla, 2006.

Arkivat dhe privatizimi, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë, 2003.

Jusuf Osmani, *Lënda arkivore private*, «Vjetari i Arkivit të Kosovës», nr. XXXVII-XXXVIII, Prishtinë, 2007.